



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:226571

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05696541

KPPP.nr.982/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Banka Ekonomike” me numër biznesi 80117029, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve “IQ&A” SH.P.K., me numër unik identifikues 810184961 me seli në Prishtinë rr. “Muharrem Fejza” p.n., përfaqësuar nga A.P., M.P. nga Prishtina, me numër personal ... me adresë në rr. “Muharrem Fejza” p.n., A.P. nga Prishtina, me numër personal ... me adresë në rr. “Muharrem Fejza” p.n. dhe Z.P. nga Prishtina, me numër personal ... me adresë në rr. “Muharrem Fejza” p.n., duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 505/21 të datës 25.08.2021 të lejuar nga Përmbareuesi Privat Gjokë Radi me seli të zyrës në Gjakovë, me datë 16.05.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit “IQ&A” SH.P.K., me përfaqësues A.P., ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr. 505/21 i datës 25.08.2021 i lejuar nga Përmbareuesi Privat Gjokë Radi.
- II. SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri Përmbaremore P.nr. 505/21 i datës 25.08.2021 i lejuar nga Përmbareuesi Privat Gjokë Radi, sa i përket Shtojcës së Marrëveshjes së pengut Nr. 201145 të datës 25.08.2020
- III. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbaremore Shtojcës së Marrëveshjes së pengut Nr. 201145 të datës 08.05.2019 e lejuar sipas Marrëveshjes mbi Pengun Nr.201145 e datës 08.05.2019 dhe Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr. 2854/2019 dhe Ref.nr. 656/2019 e datës 10.05.2019 e hartuar nga noteri Bedri Godanci.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Banka Ekonomike” ka lëshuar Urdhrin Përmbaues P.nr.505/21 të datës 12.04.2022, me të cilin e ka lejuar përmbauesin në bazë të dokumentit përmbaues Marrëveshjes mbi Pengun Nr.201145 të datës 08.05.2019 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20190513 i datës 13.05.2019, Shtojcës së Marrëveshjes së pengut Nr. 201145 të datës 25.08.2020, Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr. 2854/2019 dhe Aktvendimi për regjistrimin e Hipotekës më Nr. 10-341-2019 të datës 10.05.2019, duke detyruar debitorët që në afat prej 7 ditësh t’ia paguaj kreditorit shumën prej 53,694.32€ (pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër euro e tridhjetë e dy cent) përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorëve nëpër të gjitha bankat komerciale si dhe sekuestrimi të pronës së paluajtshme të lënë në hipotekë e cila identifikohet me shenjën P-71010027-00041-2 me sipërfaqe prej 440m².

Debitori A.P. brenda afatit ligjor, ka paraqitur prapësim me të cilin nuk ka kundërshtuar borxhin ndaj kreditorit mirëpo ka kërkuar që urdhri përmbaues të shfuqizohet apo të shtyhet ekzekutimi i tij. Sipas debitorit për shkak të padrejtësive që janë bërë nga ana e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në lidhje me subvencionimin e debitorit, të njëjtit i është pamundësuar shlyerja e borxheve ndaj kreditorit por edhe ndaj kreditorëve të tjerë. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe Urdhrin Përmbaues P.nr. 505/21 të datës 25.08.2021 të lejuar nga Përmbauesi Privat Gjokë Radi, ta anuloj apo ta shtyjë përmbauesin.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka paraqitur kreditori, i cili ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit duke konsideruar se pretendimet e paraqitura në prapësim nuk qëndrojnë të njëjtat sipas kreditorit nuk janë bazë për anulimin e urdhrit dhe se prapësimi nga debitori është ushtruar vetëm me qëllim të prolongimit të procedurës. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të vazhdoj procedura përmbauese mbi bazën e dokumenteve përmbauese siç është lejuar përmes Urdhrit Përmbaues P.nr. 505/21 të datës 25.08.2021.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbauese, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi pjesërisht duke vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsytet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Shtojca e Marrëveshjes së pengut Nr. 201145 e datës 25.08.2020, nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, respektivisht nuk është paraqitur në përputhje me nenin 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar...”*.

Në këtë drejtim, në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë”* gjykata erdhi në përfundim se urdhri për lejimin e përbarimit duhet të anulohet sa i përket Shtojcës së Marrëveshjes së pengut Nr. 201145 e datës 25.08.2020, pasi që dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi nuk ka titull ekzekutiv, pasi që nuk është paraqitur në formën përcaktuar ligjore.

Gjykata la në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përbarimor P.nr. 505/21 i datës 25.08.2021 i lejuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, sa i përket Marrëveshjes mbi Pengun Nr.201145 e datës 08.05.2019, në përputhje me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 5, par. 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore përcaktohet se dokument përbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*, si dhe sa i përket Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr. 2854/2019, duke u bazuar në nenin 22, par. 1.7 ku përcaktohet se *“1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”*.

Gjykata gjeti se Marrëveshja mbi Pengun Nr.201145 e datës 08.05.2019 dhe Kontrata mbi Hipotekën LRP.nr. 2854/2019 dhe Ref.nr. 656/2019 e datës 10.05.2019 e hartuar nga noteri Bedri Godanci, i plotësojnë kushte për të qenë dokumente përbarimore dhe janë titull ekzekutiv, pasi që të njëjtat janë paraqitur në kopje të noterizuara dhe atë Marrëveshja mbi Pengun Nr.201145 e datës 08.05.2019 është paraqitur në formën e kërkuar ligjore pasi që e njëjta është dorëzuar bë kopje të noterizuar përmes aktit noterial LRP.nr.5481/2121 pranë zyrës

noteriale të noterit Arësim Avdijaj me datë 18.06.2021 dhe të njëjtës i është bashkangjitur Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20190513 i datës 13.05.2019, po ashtu Kontrata mbi Hipotekën LRP.nr. 2854/2019 është dorëzuar në kopje të noterizuar përmes aktit noterial LRP.nr.2854/2019 pranë zyrës noteriale të noterit Arësim Avdijaj me datë 10.05.2021, dhe të njëjtës i është bashkangjitur Aktvendimi për regjistrimin e Hipotekës më Nr. 10-341-2019 të datës 10.05.2019.

Andaj, gjykata la në fuqi Urdhrin Përmbartimorë Urdhri Përmbartimor P.nr. 505/21 i datës 25.08.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, mbi bazën e dokumenteve përmbartimore të lartcekura, pasi që gjeti se dokumentet në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi janë paraqitur në formën e kërkuar ligjore, në përputhje me nenin 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit.”.*

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës vlerësoi se nuk është e nevojshme të caktohet seancën gjyqësore, meqë nga shkresat e lëndës gjendja faktike dhe juridike ishte qartë dhe vlerësoi të panevojshëm caktimin e seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.982/22, datë 16.05.2024

Numri i lëndës: 2021:226571
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05696541

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.